



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 2003/1 prot.,

Tiranë, më 15.12 2023

UDHËZIM
PËR

ZBATIMIN E PARIMEVE NË ANKETAT STATISTIKORE TË QUMËSHTIT DHE
NËN-PRODUKTEVE TË TIJ¹

Nr. 2, datë 15.12 2023

Bazuar në ligjin nr. 30/2022 "Për miratimin e programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026, neneve 17/4 dhe 20/b të ligjit nr. 17/2018 "Për statistikave zyrtare", VKM nr. 122 datë 01.03.2023 "Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023-2025 (PKIE 2023-2025) me qëllim krijimin e kuadrit rregullator për përcaktimin e parimeve për anketat statistikore të qumështit dhe nën-produkteve të tij

U D H Ë Z O J:

1. Anketat statistikore të qumështit dhe nën-produkteve të tij të kryhen në përputhje me parimet e Aneksit 1 dhe Aneksit 2, të këtij Udhëzimi.
2. Planifikimi dhe zbatimi i Aneksit 1 dhe Aneksit 2 të këtij Udhëzimi të pasqyrohet në Planin Vjetor përkatës për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, me synim rritjen e nivelit të përputhshmërisë me kërkesat e Direktivës së Këshillit (96/16/KE) dhe Vendimit të Komisionit (97/80/KE).
3. Ngarkohet Drejtorja e Përgjithshme e Prodhimit Statistikor për zbatimin e këtij Udhëzimi.
4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI PËRGJITHSHËM
ELSA DHULLI



¹ Ky udhëzim është përafshuar pjesërisht me:

1. Direktiva e Këshillit (96/16/KE), datë 19 mars 1996, mbi anketat statistikore të qumështit dhe të produkteve të tij;
2. Vendimit të Komisionit (97/80/KE) që përcakton dispozitat për zbatimin e Direktivës së Këshillit 96/16/KE mbi anketat statistikore të qumështit dhe të nën-produkteve të tij.